



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1015/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Faton Ademi me zyrtaren ligjore Biondina Zeneli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit N.T ”I...” me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson “A...” Sh.p.k, kundër debitorit Telekom i Kosovës, Sh.a me seli në Prishtinë, për përmbushjen e borxhit, duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.1687/18, i datës 05.05.2020, me datë 10.11.2021 mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e debitorit Telekom i Kosovës, Sh.a Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.1687/18, i datës 05.05.2020, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin PPP.nr.1687/18, i datës 05.05.2020 në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit “Telekomi i Kosovës” Sh.a me seli Prishtinë, datë 10.12.2018 dhe Urdhri i Përmbartuesit Privat E.SH, P.nr.483/2018, i datës 03.12.2018 ka mbetur në fuqi. Në pikën II të dispozitivit është obliguar debitori Telekom i Kosovës Sh.A., që në emër të shpenzimeve të shkaktuara t’ia paguaj kreditorit N.T. ”I...” shumën 104.00 euro.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, me të cilin e atakon aktvendimin për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit, ndërsa aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim pranë organit përmbarues me datë 03.12.2018. Organi përmbarues me urdhrin, P.nr.483/2018, i datës 03.12.2018 ka lejuar përmbarimin.

Debitori në afatin ligjor ka parashtruar prapësim kundër urdhrin të organit përmbarues me propozim që të aprovet prapësimi si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbarimor.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, PPP.nr.1687/18, i datës 05.05.2020 ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit duke vendosur më saktësisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shikimit të shkresave të lëndës, si dhe provave të gjendura, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar. Gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se në bazë të faturës nr.4416 e datës 24.11.2017, në vlerën 9000.00 euro, kjo shumë është faturuar nga kreditori ndaj debitorit për periudhën e shërbimit 25.09.2017 deri me 24.11.2017 për mirëmbajtjen e klimave Stulz. Sipas gjykatës ky dokument në shkresat e lëndës është prezantuar në origjinal me të gjitha elementet përkatëse të një dokumenti të besueshëm, konform dispozitës së nenit 29 lidhur me nenin 40.1.3 dhe 37 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori dhe mban vulën e pranimit 27.01.2017, me nr. protokollit 04-1 3231/17.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se Aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale.

Debitori në ankesën e parashtruar pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike për faktin se gjykata gabimisht konstaton faktin, prova në rastin konkret fatura, nr.B4416 e datës 24.11.2018, debitorit të përmbarimit nuk i është dorëzuar në origjinal e as në kopje të vërtetuar por vetëm në kopje të pavërtetuar. Debitori pretendon se në kopjen e faturës nuk figuron se ndonjë zyrtar i Telekomit të Kosovës e ka pranuar mallin e cekur.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet e mësipërme ankimore, mirëpo konsideron se të njëjtat janë të pa themelta. Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike për arsye se në shkresat e lëndës gjendet fatura në bazë të t' cilës është bërë edhe propozimi për përmbarim. Fatura në fjalë rezulton të jetë e nënshkruar nga ana e kreditorit dhe e pranuar nga ana e debitorit, ku në këtë faturë figuron vula e debitorit, me nr. të protokollit 04-1 3231/17, e datës 27.11.2017 andaj në këtë rast nuk mund të qëndrojnë pretendimet e debitorit se e njëjta nuk e ka pranuar faturën.

Debitori në ankesën e parashtruar pretendon se gjykata e shkallës së parë ka bërë edhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale sepse gjykata ka vepruar në kundërshtim me nenin 36 par.1 të LPP-së, ku sipas debitorit propozimit për përmbardim i dorëzohet edhe dokumenti përmbardues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbardueshmërisë për përmbardueshmëri, e po ashtu pretendon se është vepruar edhe në kundërshtim me nenin 36 par.4 të LPP-së. Tutje debitori pretendon se është vepruar në kundërshtim edhe me nenin 38 par.1 të LPP-së për shkak se propozimi për përmbardim duhet të përmbajë kërkesën për përmbardim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbardimor në kopje të vërtetuar apo në origjinal, duhet të tregohet debitori dhe kreditori, kredia që kërkohet të realizohet si dhe mjeti nëpërmjet të cilit duhet kryer përmbardimi, objekti i përmbardimit po që se është e njohur si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme në zbatimin e përmbardimit.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e debitorit lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale mirëpo, vlerëson se meqenëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë është zbatuar drejtë edhe e drejta materiale. Lidhur me pretendimin e debitorit se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me nenin 36 të LPP-së, ky pretendim nuk qëndron dhe atë për arsye se neni në fjalë i referohet vërtetimit të përmbardueshmërisë në raport me dokumentet përmbarduese, ndërsa në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokument përmbardues mirëpo kemi të bëjmë me dokument të besueshëm –faturën, e për të cilën për të qenë e përshtatshme për përmbardim do të vijë në shprehje zbatimi i nenit 37 të LPP-së i cili përcakton se: *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumenti të besueshëm, mjafton që propozimit ti bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e vërtetuar sipas ligjit”*. Në këtë rast dokumenti i besueshëm fatura, i është bashkëngjitur propozimit për përmbardim në origjinal dhe atë e nënshkruar dhe e vulosur nga ana e kreditorit, si dhe e pranuar me vulë nga ana e debitorit, kështu duke qenë në përputhje edhe me nenin 29 par.1 pika 1.1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1 kambialet dhe çeket me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës”*.

Po ashtu, edhe propozimi për përmbardim është bërë në përputhje me nenin 38 par.1 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbardim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbardim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbardimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbardimi, kërkuesi i përmbardimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet të cilit duhet kryer përmbardimi, objekti i përmbardimit po që se është e njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbardimit.”* Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, propozimi për përmbardim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me dispozitën e sipërcituar, andaj edhe kjo Gjykatë e përkrah vendimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.

Pranimi i faturës në mënyrë të rregullt është si garancion për debitorin që i njëjti të ketë mundësi të përmbushjes vullnetare të detyrimit, para se i njëjti të kërkohet të përmbushet në mënyrë të

dhunshme në gjykatë, dhe për gjykatën është e rëndësishme për vlerësimin se kërkesa e kreditorit në raport me debitorin a është bërë e kërkueshme në aspektin kohor.

Debitori me asnjë provë nuk ka arritur që ti bëjë të besueshme pretendimet e tij në ankesë, e duke pasur parasysh se është detyrë e çdo pale që në përputhje me ligjin të paraqesin provat e nevojshme që vërtetojnë faktet mbi të cilat i bazojnë pretendimet e tyre, gjykata gjeti se nuk ka bazë që pretendimet e kreditorit të merren si të bazuara ashtu, që të merrej një vendim ndryshe prej atij si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Andaj, Gjykata e Apelit vlerësoi se pretendimet e debitorit në ankesë janë të pa themelta, pasi në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm i cili i plotëson kushtet për përmbarim, dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga arsyet e parapara sipas Ligjit të Procedurës Përmbarimore, për ta aprovuar apo bazuar ankesën e debitorit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.1015/21, të datës 10.11.2021

Gjyqtari,  
Faton Ademi